REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr./Br. 14/23
Date/Datum. 26.04.23
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubljanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 14/23

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105,106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga: Kimete Gashi Kryetare, Agon Ramadani antarë dhe Vedat Poterqoi duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik (OE) "Infinitt" sh.p.k. me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me material ndricues elektrik për ndertesa qeveritare" me nr Prokurimit Nr. 214-22-13073-121,iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)-Ministria e Punëve të Brendshme, me datën 25.04.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet, si e bazuar ankesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik "Infinitt" sh.p.k. me seli në Prishtinë, e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 05.01.2022 (me numër protokolli 14/2023) për aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me material ndricues elektrik për ndertesa qeveritare", me nr Prokurimit Nr. 214-22-13073-121,iniciuar nga Autoriteti Kontraktues,Ministria e Punëve të Brendshme.

II. Anulohet, B58 Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhënie të kontratës i datës 20.12.2022, për aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me material ndricues elektrik për ndertesa qeveritare" me nr Prokurimit Nr. 214-22-13073-121,iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Ministria e Punëve të Brendshme, ndërkaq aktiviteti i prokurimit i lartë përmendur kthehet në **rivlersim.**

III. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informoj Panelin Shqyrtues të OSHP, për gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, i përshkruar si në paragrafin paraprak të dispozitivit të këtij vendimi. Në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarr masa ndaj AK për

mos respektim të vendimit, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (versioni i konsoliduar).

IV. Me qenë se ankesa e parashtruar nga ankuesja "Infinitt" sh.p.k. me seli në Prishtinë, aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

V. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 20.12.2022,Ministria e Punëve të Brendshme në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin autoritetit kontraktues për dhënie të kontratës për aktivitetit të prokurimit me titull: "Furnizim me material ndriçues elektrik për ndertesa qeveritare" me nr Prokurimit Nr. 214-22-13073-121, ku është rekomanduar për kontratë OE Kos-Contruction sh.p.k.& Muharrem Hoti B.I, me seli në Malishevë.
Me datë 29.12.2022, ankuesi "Infinitt" sh.p.k., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pran AK-Ministria e Punëve të Brendshme, me datë 29.12.2022, e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim dhe e ka vërtetuar B58 Njoftimin mbi vendimin autoritetit kontraktues të datës 20.12.2022.
Me datën 05.01.2023 OE "Infinitt" sh.p.k., nga Prishtina, ka parashtruar ankesë në OSHP-ë, me numër të protokollit 14/2023, kundër njoftimit për dhënie të kontratës të aktivitetit të prokurimit të përshkruar si më sipër.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedura të hapur, lloji i kontratës: Furnizime, vlera e parashikuar e kontratës: 80,000,00 € vlere e madhe.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.
Organi Shqyrtues i Prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 17 janar 2023 me raportin e ekspertizës.

Me datë 18 janar 2023 OE "Infinitt" sh.p.k., nga Prishtina, ka deklaruar se nuk pajtohem me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Me datë 18 janar 2023 AK Ministria e Punëve të Brendshme, ka deklaruar se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me ketë, me 16.01.2023, eksperti i jashtëm shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- ankesa e OE "Infinitt" sh.p.k., me seli në Prishtinë,të aprovohet si e bazuar.

- të anulohet Njoftimi mbi Vendimin e AK-së i datës 20.12.2022 ndërkaq aktiviteti i prokurimit me të dhënat si më sipër shënuar të kthehet në rivlërsim.

Pretendimin ankimor 1

Elaborat më të detajishëm të pretendimeve ankimore paraqesim si në vijim:
OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm pasi që nuk ka dorëzuar / plotësuar deklaratën për specifikime teknike sipas kërkesës ne nenin 3.1 të FDT-së, citoj:

Specifikacionet teknike të detyrueshme

3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentet dëshmuese për qëllimin e ofruar të kontratës, duke përfshirë:

a. Deklaratën për specifikacionet teknike për mallrat e ofruara te cilat përputhen me ato të përmendura ne Aneksin 1 te dosjes se tenderit.

Përgjigjja në pretendim 1

AK i MPB ka kërkuar deklaratën e specifikimeve teknike në FTD dhe pretendimi i OE ankues lidhur me deklaratën e specifikimeve teknike se OE i rekomanduar për kontrate nuk e ka , sipas konstatimeve te ekspertit shqyrtues Oferta e OE të rekomanduar për kontratë nuk e ka deklaratën për specifikacionet teknike për mallrat e ofruara si që është kërkuar në dosjen e tenderit në FTD pika 3.1.

Duke u bazuar në nenin 59 te LPP-së Eksperti shqyrtues në bazë të ofertës që ka dorëzuar kompania e rekomanduar dhe në bazë të interpretimit të KRPP-së konstatojë se kompania e rekomanduar "Kos-Construction" sh.p.k nuk e ka plotësuar kriterin e kërkuar në dosjen e tenderit dhe pretendimi ankimor është i qëndrueshëm.

Shiko interpretimin e KRP-së:

Republika e Kosovës/Republika Kosovo/Republic of Kosovo
Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
Regulatorna Komisija za Javne Nabavke
Public Procurement Regulatory Commission

Për:	
Përmes:	Osman Vishaj – Kryetar Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
CC	Arbnora Cukolli – Luxha Koordinatore e Departamentit të Rregullave - KRPP
Nga:	Antigona Rexhepi-Shegiri Zyrtare Ligjore e Departamentit të Rregullave-KRPP
Lënda:	Përgjigje Kërkesës për Interpretim të dt. 12.05.2021
Datë:	01.06.2021

TU nderuar,

Konform neniit 87, paragrafit 2, nën paragrafët 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në pyetjen e parashtruara, KRPP sqaron si në vijim:

Sipas neniit 49 të LPP-së, ekzamijimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve është komponenti dhe përgjegjësi e plotë e autoritetit kontraktues.

Në përputhje me paragrafin 4 te këtij neni, *"Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjithë kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit..."*

Kurdo që kërkohet Deklarata për specifikimet teknike në FTD të Dosjes së Tenderit, ajo duhet të dorëzohet së bashku me dokumentet e tenderit.

Me respekt

Vërejtje: Interpretimi i dërguar nga KRPP, i bëhet vetëm njësisë së prokurimit nga ana juaj dhe asnjë palë e tretë nuk i lejohet ankimimi i problemit.

Pretendimin ankimor 2

Grupi i OE-së të rekomanduar për kontratë po ashtu janë të pa përgjegjshëm pasi që nuk i kanë dorëzuar listën e kontratave sipas kërkesës lidhur me kapacitetin teknik & profesional të përshkruar në nenin 9.1&9.2 të FDT-së:

Përgjigjie në pretendim 2

Pretendimi i OE "Infinitt" sh.p.k ankues është se kompania e rekomanduar për kontratë nuk e ka dorëzuar Listën e kontratave mirëpo sipas ekspertit shqyrtues ne përputhje me nenin 59 dhe nenin 72 të LPP-së AK mundet të ja kërkoj sqarime shtesë –Listën e referencave për Referencat që ka dorëzuar me ofertë. Mirëpo AK para se të bëjë sqarimin duhet të vlerësoj se ato referenca që ka dorëzuar me ofertë a e plotësojnë kriterin/kushtin e kërkuar në dosjen e tenderit tani të kërkoj sqarimet në përputhje me nenin 72 të LPP-së.

Në bazë të RRUOPP nenit 39.8 të kësaj rregullore munden të kërkohen sqarime shtesë

Lista e kontratave të realizuara nuk është dorëzuar por janë dorëzuar dëshmitë (referenca/certifikata e pranimit/kontrata)	Mund të kërkohen informata sqaruese	69

Në bazë të kësaj të cekura më lartë eksperti shqyrtues duke u bazuar në analizën e fakteve dhe dëshmive konstaton se ky pretendim ankimor nuk qëndron pasi AK-ja ka të drejtë ti sqaron Listën e referencave për kontratat dhe referencat që i ka dorëzuar me ofertë. AK-ja sipas Ligjit duhet ta sqaron me OE referencat që ka dorëzuar listën e referencave mirëpo AK-ja duhet ti vërteton referenca/kontratat që i ka dorëzuar OE i rekomanduar për kontratë dhe OE tjerë të ju kërkohen origjinalet e faturave që ka dorëzuar që ka furnizuara janë të ngjashme.

Pretendimi 3

Grupi i OE po ashtu janë të papërgjegjshëm për faktin se policen (sigurimin e tenderit) nuk e kanë dorëzuar sipas kërkesës së AK në Aneks 4 të dosjes së tenderit citoi kërkesën në nenin 13.1 të FDT-së:

Ndërsa forma e dorëzuar nga grupi i OE është jo-valide pasi që nuk është nënshkruar nga kompania e sigurimeve si dhe nuk është konform formës ligjore /standard sipas ANEKS 4 në dosjen e tenderit.

Sigurimi i tenderit nuk përmban kushtet e përcaktuara sipas formës standarde pjesë e DTI Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtutjeshëm/ baza ligjore neni 57 i LPP-së.

Përgjigjie në pretendim 3

Kompania e rekomanduar për kontratë ka dorëzuar sigurimin e tenderit të formës që e kanë kompanitë e sigurimeve e jo të formës së dosjes së tenderit. Mirëpo sigurimi i tenderit e ka titullin e tenderit që është lëshuar për ketë tender dhe vlerën e sigurimit që është kërkuar ndërsa është i pa nënshkruar dhe nuk i ka të gjitha kushtet që kërkohen me formën e dosjes së tenderit Aneksit 4 Sigurimi i ofertës. Sigurimi i lëshuar nga kompania e sigurimeve është i vulosur nga kompania e sigurimeve por i pa nënshkruar. Eksperti shqyrtues mendon sa i përket sigurimit të tenderit që nuk është i nënshkruar për ketë nuk duhet të ketë ndonjë problem pasi e ka vulën dhe AK duhet të vërtetoj këtë duke bërë sqarime me kompaninë e sigurimeve se a është i lëshuar nga kompania e sigurimeve dhe pse është i pa nënshkruar kjo vërtetohet.

Mirëpo sa i përket kushteve që nuk i ka të gjitha që kërkohen në Aneksin 4 atëherë duhet AK të shpallë si të pa vlefshëm, në bazë të nenit 27 te LPP-së dhe të RRPP nenit 17 dhe nenit 39.8 të RRUPP dhe konstatimeve të këtyre të cekura më lartë eksperti shqyrtues mendon se pretendimi ankimor është bazuar.

Pretendimi 4

OE i rekomanduar për kontratë po ashtu është i papërgjegjshëm pasi që ka modifikuar listën e çmimeve, nuk i është përmbajtur formës se përpiluar nga AK.

Në kolonën 4 është kërkuar çmimin për njësi me TVSH ndërsa në kolonën 5 çmimi total me TVSH që nënkupton sasia 1 x çmimi për njësi jep totalin me TVSH.

OE në kolonën 5 ka vendosur gabimisht çmimin e peshuar, çmimi i peshuar është kërkuar të kalkulohet vetëm në tabelën e fundit te rekapitullimi.

Ndërhyrja/modifikimi i dosjes së tenderit apo para masës nga OE nuk është i lejuar. Edhe sikur të lejohej ligjërisht në këtë formë është e pamundur dhe implementimi i kontratës në fjalë kur dihet se OE ne faturim do të paraqesë çmime tjera për njësi nga ato të cekura në kolonën 4 të përshkrimi i çmimeve.

Përgjigjie në pretendim 4

Sa i përket këtij pretendimi kompania e rekomanduar ka bërë peshimin e poenëve të çdo çmimi njësi totali që i bie se i ka llogaritur çmimin e poentuar në tabelën e artikujve të totali i tabelave.

Mirëpo AK nuk e ka cek se nuk kanë të drejtë OE – të bëjnë peshimin e çdo çmimi të ofertuar dhe OE i rekomanduar ka peshuar çmimet në rregull sipas ekspertit pasi te tabela e rekapitullimit është peshuar çmimi sipas përqindjes që ka kërkuar AK-ja dhe për këtë pretendim eksperti shqyrtues mendon se është i pa bazuar pretendimi për faktin se peshimi si të bëhet në tabelën e çmimeve si në tabelën e rekapitullimeve llogaritja del njësoj.

Në bazë të fakteve dhe sqarimeve që kemi shqyrtuar, si dhe përgjigjet e cekura më lartë eksperti shqyrtues mendon se Ankesa e "Infinitt" sh.p.k. të cilësohet e bazuar dhe të rishqyrtohet Njoftim mbi Vendimin e AK-së.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e cekura më lartë, Eksperti i propozon OSHP-së, të rishqyrtohet B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK-së për tenderin me titull: "Furnizim me material ndriçues elektrik për ndërtesa qeveritare nr. me nr Prokurimit Nr. 214-22-13073-121 ; Nr. i brendshëm 214-22-122-121 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) e Ministria e Punëve të Brendshme.

Ankesa e "Infinitt" sh.p.k. në tenderin e shpallur nga Ministria e Punëve të Brendshme me titull "Furnizim me material ndriçues elektrik për ndërtesa qeveritare 214-22-13073-12, Nr. i brendshëm 214-22-122-121 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Ministria e Punëve të Brendshme, të cilësohet e bazuar.

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtresat e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues diskutimeve dhe administrimit të provave në tërësi, e të gjithë aktivitetit të prokurimit të lartë shënuar, sqaron :

Paneli shqyrtues lidhur me pretendimin e parashtruar të OE ankues i cili pretendon se OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka dorëzuar deklaratën e specifikimeve teknike si që është kërkuar në dosjen e tenderit në FTD pika 3.1., PSH konstaton se AK nuk ka specifikuar ose veçuar ndonjë deklaratë specifike apo katalog/broshur lidhur me specifikacionet teknike të Aneksit 1 ku formë e tillë është formë standarde dhe si i tillë nuk është kriter vlerësues, me këtë rast PSH vlerëson se pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Sa i përketë pretendimit tjetër të OE ankues i cili pretendon se OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka dorëzuar Listën e kontratave, PSH sqaron se OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar kontratat dhe referencat sipas kërkesës së vendosur në DT por mungon lista e kontratave andaj Paneli Shqyrtues obligon AK gjatë rivlerësimit në përputhje me nenin 59 dhe nenin 72 të LPP-së të kërkoj sqarime shtesë –Listën e Kontratave dhe si e tillë të plotësohet furnizimet e përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin,

Paneli shqyrtues lidhur me pretendimin ankimor rreth sigurimit të tenderit me të cilin OE ankues pretendon se OE i rekomanduar nuk ka sjellur sigurimin e tenderit sipas formës dhe se mungon nënshkrimi i tij, PSH sa i perkete formës së dorëzuar të sigurmit të tenderit konsideron se i njëjti përmban numër të aktivitetit si dhe përmban emrin e aktivitetit mirëpo obligon AK gjatë rivlerësimit të kërkohen sqarime shtesë konform dispozitave ligjore të nenit 72 të LPP-së vetëm sa i përketë kushteve dhe formës së përcaktuar sipas Aneksit 4 të DT.

Nuk është i qëndrushëm pretendimi se OE i rekomanduar për kontratë se OE i rekomanduar është i papërgjegjshëm pasi që ka modifikuar listën e çmimeve, nuk i është përmbajtur formës se përpiluar nga AK, paneli sqaron se OE i rekomanduar për kontratë ka bërë peshimin e poenëve të çdo çmimi në njësi totali që i bie se i ka llogaritur çmimin e poentuar në tabelën e artikujve të totalit të tabelave. AK nuk e ka cek se nuk kanë të drejtë Operatorët Ekonomik të bëjnë peshimin e çdo çmimi të ofertuar dhe OE i rekomanduar për kontratë i ka peshuar çmimet në rregull, pasi te tabela e rekapitullimit është peshuar çmimi sipas përqindjes që ka kërkuar AK-ja.

Vendimi sikurse në pikën 4, të dispozitivit është marrë në kuptim të nenit 31, paragrafi 6, i Rregullores se punës se Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Paneli Shqyrtues kërkon nga AK që të njëjtit të jenë të vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik në të ardhmen duke respektuar në përpikmëri Ligjin e Prokurimit Publik dhe rregullat e zbatueshme, dhe po ashtu urdhëron të njëjtit të veprojnë në harmoni me rekomandimet e dhëna në këtë vendim, në të kundërtën Organi Shqyrtues i Prokurimit nga kuadri i Paneleve Shqyrtuese, ka të drejtë të kërkoj ndërmarrjen e masave disiplinore ndaj zyrtarëve përgjegjës të prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitv të këtij vendimi.

Kryetarja e Panelit Shqyrtues
Kimete Gashi

_____

KËSHILLË JURIDIKE:
Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:
1x1 AK Ministria e Punëve të Brendshme
1x1 OE "Infinitt" sh.p.k. me seli në Prishtinë
1x1 Arkivës së OSHP-së;
1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.